

AKT THEMELIMI
I
SHOQERISE "LEO CONSTRUCTION" shpk

KREUI

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezigjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emertimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte: "LEO CONSTRUCTION" shpk.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria "LEO CONSTRUCTION" shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (ketu e ne vijim referuar "Shoqeria"). Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria, pasi te kete fituar personalitetin juridik, eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.

Neni 3

Shoqeria e ka Seline, Ndertese, Zk nr.1812, vol.6, faqe 201, me pasuri nr.72/100, Laç.

Neni 4

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar .Ky afat mund te zgjatet ose shkurtohet vetem me vendim te Asamblese se ortakeve. Shoqeria "LEO CONSTRUCTION" shpk gezon statusin e personit juridik shqiptar qe nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin e QKR-se.

Neni 5

Kohezigjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar.



Neni 6

Shoqëria "LEO CONSTRUCTION" shpk do të ketë si objekt :

Ne fushën e investimeve dhe ndertimeve në të gjithë sektorët e ekonomisë si: ndërtimin e ndërtesave publike dhe private, rrugëve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, digave dhe veprave bonifikuese e ujore, ujesjellesave, linjave mbitokesore dhe nentokesore për energji dhe telekomunikacionet, ndërtimin dhe rehabilitimin e veprave ujëtare, centraleve, objekteve turistike, objekteve ushtarake, të kultit, kulturore, bujqësore, rrjeteve inxhinierike, porteve, aeroporteve, objekteve industriale, pakufizim si dhe investimi, ndërtimi dhe zhvillimi i ambienteve/shërbimeve në sektorin e arsimit parauniversitar, duke përfshirë arsimin e përgjithshëm dhe arsimin në fushën e bujqësisë. Tregëti artikuj të ndryshëm, import-eksport etj. Tregëti import-export me shumicë dhe pakicë të çdo lloji malli të parashikuar në tabelat doganore të Republikës së Shqipërisë. Import-eksport të makinave dhe makinerive të renda, autoveturave të të gjitha llojeve dhe tregëtimin e pjesëve të ndërrimit, dhenien me qera të tyre etj. Agjensi transporti, publicitet, reklama dhe propagandë. Nxjerrjen e mineraleve për industrinë kimike dhe të plehrave, tregëtim me shumicë të metaleve dhe të xeherëve metalor, tregëti me shumicë e drurit dhe materialeve ndërtimore dhe pajisjeve hidrosanitare, hoteleri dhe bar-restorante, etj.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga organi kompetent i një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogelimit të kapitalit u komunikohet eksperteve kontabel të autorizuar, në rast se ka të tillë, të pakten 45 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblese të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogelimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshëm marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të pakten deri në vlerën minimale.

Në të kundërt shoqëria duhet të shnderrohet në një formë tjetër.

Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo person i interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë.

Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mbledhet për të marrë vendim.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar. Projekti i transferimit i njoftohet shoqerise dhe secilit prej ortakeve. Ne rast se shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit sipas paragrafit te mesiperem, miratimi i transferimit konsiderohet i dhene.

Ne rast se shoqeria refuzon te jape miratimin e transferimit, ortaket, brenda tre muajve nga data e ketij refuzimi, duhet te blejne apo te lejojne blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar me vleren e percaktuar sipas rregullave te nenit 11 te ketij ligji.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jane te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve. Gjithashtu jane te transferueshme ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleje e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakeve branda nje afati prej gjashte muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogarite vjetore, te hartuara nga administratoret.

Vendimet merren pas konsultimit me shkrim te ortakeve, ne rast se ortaket miratojne me shkrim permbajtjen e konsultimit. Ortaket lajmehohen me leter rekomande te pakten 15 dite perpara mbledhjes se asamblese. Ne kete leter njohtohet rendi i dites. Lajmerimi behet nga administratori ose, ne mungese te tij, nga eksperte kontabel i autorizuar, po qe se ka te tille. Secili ortak mund te kerkoje ligjerisht caktimin e nje mandatmbajttesi te ngarkuar per thirrjen e asamblese dhe caktimin e rendit te dites.

Cdo mbledhje e asamblese e thirrur ne menyre te parregullt, mund te anulohet. Megjithate anulimi nuk ka vlere, ne rast se ortaket jane te pranishem ose te perfaqesuar.

Secili ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Secili ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjeter.

Ai mund te perfaqesohet edhe nga nje tjeter person.

Neni 10

Ndryshimet e Statutit



Ndryshimet e statutit vendosen nga ortaket qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 11
Administrimi

Administratori i shoqerise caktohet, **Leonora RADI** e cila do te ushtroje funksionet ne kete detyre per nje periudhe 5 vjecare.

Administratori emerohet dhe shkarkohet nga vendimi i asamblese se ortakeve qe perfaqesojne me teper se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar. Pervec kesaj, administratori shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjit me kerkese te cdonjerit prej ortakeve.

Neni 12
Kompetencat

Shoqeria administrohet nga nje Administrator. Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori perfqeson Shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shtetore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, vec e vec ose se bashke, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ua jep shprehimisht ortakeve.

Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Administratori ka te drejte qe te celi llogari bankare dhe te kryejne veprime prane bankave te te gjitha niveleve kudo ku shoqeria disponon llogari bankare.

Administratori ka te gjitha kmpetencat per te punesuar personelin e shoqerise duke respektuar dispozitat e Kodit te Punes.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i Administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti qe kufizojne kompetencat e administratorit, te cilat rrjedhin nga ky nen, duhet te respektohen nga te tretet.



Administratorit ose ortakeve qe nuk jane persona juridike nuk u lejohet te kontraktone ne cfaredolloj forme qofte, te marrin hua te shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj, per paradhenie si dhe te behen dorezenes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshe e pavlefshme.

Neni 13

Pergjegjesite

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleje qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose sebashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkatuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme.

Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

Ortakut qe nuk eshte administrator, ka te drejte ne cdo kohe te informohet personalisht per veprimtarine e shoqerise dhe te njihet me llogarite dhe dokumentat e shoqerise.

Neni 14

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15

Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratoret.

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividendeve, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, sic edhe parashikohet nga ligji, ne raport me kuotat e zoteruara nga secili prej ortakeve.

Neni 16

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetore dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e Asamblese se Ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ia paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe kane.

Neni 17

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim te ortakeve, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te vecante, krijimin e Rezerves Ligjore. Rezerva Ligjore krijohet vit pas viti nepermjet lenies menjane te nje shume te barabarte me 5% te fitimit neto te realizuar gjate secilit vit financiar, deri sa te arrihet nje shume e barabarte me 10% te kapitalit themeltar te Shoqerise.

Neni 18

Te ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve te shoqerise.

Neni 19

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit te afatit per te cilin eshte krijuar sic mund te jene:


- a) Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimet te metejshem te veprimtarise se saj.
- b) Ne nje nga menytrat e parashikuar nga ligji "Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare".
- c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Neni 20

Bashkimi dhe ndarja

Shoqeria me ane te bashkimit, mund t'i kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ajo themelon.



Shoqeria gjithashtu me ane te ndarjes mund t'i kaloje trashegimine e saj disa shoqerive te tjera ekzistuese ose disa shoqerive te reja.

Ortaket e shoqerise, qe bejne kalimin e trashegimise se saj ne kuadrin e operacioneve te permendura me lart perfitojne pjese te kapitalit themeltar nga shoqeria ose shoqerite perfituese dhe sipas rastit nje kompensim me para, vlera e te cilit nuk mund te kaloje 10 % te vleres nominale te pjeseve te kapitalit themeltar te dhena.

Operacionet e permendura me lart mund te realizohen ndermjet shoqerive te formave te nddryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim te shoqerise qe zhduket, dhe kalimin e plote te trashegimise se saj te shoqerite perfituese, ne gjendjen ne te cilen ndodhet kjo trashegimi ne daten e realizimit perfundimtar te operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njekohesisht per ortaket e shoqerive qe zhduken marrjen e cilesise se ortakeve te shoqerive perfituese sipas kushteve te percaktuar ne kontraten e bashkimit ose ndarjes.

Neni 21

Afati i miratimit te likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parshikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokunetat qe duhen depozituar ne QKB.

Neni 22

Likuidatori eshte i detyruar qe te jete i vemendshem dhe korrekt, si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtatasve te vecante apo personave fizike apo juridike vendas apo te huaj.

Neni 23

Cdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund te lind gjate ushtrimit te veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe pergjithesisht ortaket duhet ta zgjidhin me mirekuptim, ne te kunderten ceshtja mund te behet objekt konflikti gjyqesor ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 24

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt-themelimi, statutin e saj dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Neni 25

Mosmarrveshjet



Per mosmarrveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij akt-themelimi, si dhe per cdo mosmarrveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26

Dispozita perfundimtare

Ky akt-themelimi u reduktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare "LEO CONSTRUCTION" shpk, dhe nenshkruhet ne Tirane, sot me date 16.03.2024

ORTAKU I VETEM

Leonora RADI

Leonora Rado

A handwritten signature in cursive script, appearing to read 'Leonora Rado', with a stylized flourish below it.